

## RELACION

### PËR PROJEKTVENDIMIN

#### PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE, FUNKSIONIMIN, SI DHE MËNYRËN E USHTRIMIT TË PËRGJËGJËSIVE TË KOMISIONEVE KËSHILLIMORE PËR TITUJT E NDERIT

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve, funksionimin, si dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive të Komisioneve Këshillimore për Titujt e Nderit” ka si qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për ngritjen, organizimin, funksionimin dhe ushtrimin e përgjegjësive të Komisioneve Këshillimore për Titujt e Nderit, në zbatim të pikës 4, të nenit 14, të ligjit nr. 94/2022, “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektvendim synon krijimin e një kuadri të qartë procedural dhe administrativ për shqyrtimin e nismave dhe propozimeve për dhënien e titujve të nderit, duke garantuar transparencë, paanshmëri dhe standarde të njëjta vlerësimi për çdo kandidaturë.

Nëpërmjet këtij akti synohet:

- a) përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve këshillimore;
- b) mënyra e organizimit dhe funksionimit të komisioneve këshillimore;
- c) garantimi i shqyrtimit objektiv dhe profesional i kandidaturave të propozuara për tituj nderi;
- ç) të sigurohet respektimi i standardeve të integritetit, transparencës dhe shmangies së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit;
- d) të përcaktohen procedurat për administrimin e dokumentacionit, marrjen e informacionit shtesë dhe hartimin e rekomandimeve për institucionet përgjegjëse për dhënien e titujve të nderit.

Projektvendimi synon gjithashtu forcimin e besueshmërisë publike ndaj procesit të dhënies së titujve të nderit, duke krijuar mekanizma të qartë për verifikimin dhe vlerësimin e meritave të kandidatëve.

#### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për Ministrinë e Punëve të Brendshme, për vitin 2026.

---

Relacion shpjegues mbi projektvendimin “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve, funksionimin, si dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësive të Komisioneve Këshillimore për titujt e nderit”

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Miratimi i këtij projektvendimi krijon bazën e nevojshme procedurale për funksionimin e komisioneve këshillimore për titujt e nderit.

Në mungesë të një kuadri të detajuar procedural, shqyrtimi i kandidaturave për titujt e nderit mund të paraqesë problematika që lidhen me mungesën e standardeve të unifikuara, paqartësinë procedurale dhe mungesën e mekanizmave të qartë për verifikimin e informacionit.

Projektvendimi përcakton në mënyrë të detajuar mënyrën e ngritjes dhe përbërjes së komisioneve këshillimore, kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të jashtëm, procedurat e mbledhjeve dhe vendimmarrjes, detyrimin për mbajtjen e procesverbaleve, afatet për shqyrtimin e praktikave, mënyrën e administrimit të dokumentacionit dhe kërkimit të informacionit shtesë, mekanizmat për verifikimin e kandidaturave në bashkëpunim me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Efektet e pritshme të projektaktit janë, rritja e transparencës dhe besueshmërisë në procesin e dhënies së titujve të nderit, garantimi i një procesi të standardizuar dhe objektiv të shqyrtimit të kandidaturave, forcimi i integritetit institucional dhe shmangia e konfliktit të interesit, rritja e cilësisë së vlerësimit të kandidaturave nëpërmjet përfshirjes së personaliteteve të jashtme me kontribut në fushat përkatëse, krijimi i një praktike administrative të unifikuar për të gjitha institucionet përgjegjëse për dhënien e titujve të nderit.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektvendim është në përputhje të plotë me rendin juridik të brendshëm. Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të të pikës 4, të nenit 14, të Ligjit nr. 94/2022, “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”.

### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi përbëhet nga II Kapituj kryesore që rregullojnë përbërjen, organizimin dhe funksionimin e komisioneve këshillimore për titujt e nderit.

Në pjesën e parë përcaktohet përbërja e komisionit këshillimor, mënyra e ngritjes së tij dhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve. Parashikohet që komisioni të përbëhet nga 5 anëtarë, ku 3 janë përfaqësues të institucionit përgjegjës për

---

Relacion shpjegues mbi projektvendimin “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve, funksionimin, si dhe mënyrën e ushtrimit të përgjigjësisë të Komisioneve Këshillimore për titujt e nderit”

dhënien e titullit dhe 2 janë personalitete të jashtme me kontribut në fushat përkatëse.

Gjithashtu përcaktohet mënyra e shpërblimit të anëtarëve të jashtëm dhe burimi i përballimit të këtyre shpenzimeve.

Në pjesën e dytë rregullohet organizimi dhe funksionimi i komisionit këshillimor duke përfshirë:

- mënyrën e zgjedhjes së kryetarit;
- funksionin e sekretarit të komisionit;
- mënyrën e marrjes së vendimeve;
- detyrimin për respektimin e legjislacionit për konfliktin e interesit;
- afatet për ngritjen dhe funksionimin e komisionit;
- mënyrën e mbajtjes së procesverbaleve;
- procedurat e shqyrtimit të kandidaturave;
- kërkimin e informacionit nga Autoriteti i Dosjeve;
- rastet e vijimit ose mosvijimit të shqyrtimit;
- procedurat për kërkimin e dokumentacionit shtesë;
- mënyrën e hartimit të raporteve dhe rekomandimeve përfundimtare.

Gjithashtu përcaktohen afatet procedurale për trajtimin e praktikave dhe rastet kur procesi mund të shtyhet për shkak të rrethanave të paparashikuara që mund të cenojnë reputacionin e aktit të nderimit.

Në përfundim parashikohet se efektet financiare përballohen nga buxheti i institucioneve përgjegjëse për dhënien e titujve të nderit.

Hyrja në fuqi është përcaktuar 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Me zbatimin e këtij projektvendimi do të ngarkohet Presidenti i Republikës dhe dhe Këshillat Bashkiak, në cilësinë e autoriteteve përgjegjëse për dhënien e titujve të nderit.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim u hartua nga Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Turizimit, Kulturës dhe Sportit, Këshillit Konsultativ Qeverisje Qendrorë- Vetëqeverisje Vendore, Ministrisë së Arsimit dhe Ministrin të Shtetit për Pushtetin Vendor.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i këtij projektvendimi sjell efekte financiare të kufizuara, të lidhura me shpërblimin e anëtarëve të jashtëm të komisioneve këshillimore.

Sipas projektvendimit, anëtarët e jashtëm përfitojnë shpërblim në shumën 15.000 lekë për çdo procedurë shqyrtimi.

Këto shpenzime do të përballohen nga buxheti i institucioneve përgjegjëse për dhënien e titujve të nderit dhe nuk krijojnë nevojë për fonde shtesë nga buxheti i shtetit.

**PROPOZUESI  
MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME**

**Besfort Lamallari**

